REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

**Nr. 406 Prot.** **Tiranë, më 11.06.2015**

**VENDIM Nr. 64 datë 13.05.2015**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, **"Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43,** Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.8, të datës 04.06.2015, pasi shqyrtoi ***Raportin e vëzhgimeve arkeologjike*** për ***"Projektin e rrugëve të aksesit dhe urave",*** në kuadër të ***"Projektit TAP"***, realizuar nga individ i licencuar znj. Iris Pojani dhe z. Lorenc Bejko,

**VENDOSI:**

**I.** Të miratojë ***Raportin e vëzhgimeve arkeologjike*** për ***"Projektin e rrugëve të aksesit dhe urave",*** në kuadër të ***"Projektit TAP"***, realizuar nga individ i licencuar znj. Iris Pojani dhe z. Lorenc Bejko.

**II.** Investitori duhet të kontraktojë një shoqëri të licensuar në fushën e arkeologjisë, e cila do të ndjekë, nga pikëpamja arkeologjike, në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve gjatë zbatimit të projektit, duke lidhur kontratë tre palëshe më të dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.

**III.** Gjatë zbatimit të punimeve të realizohet mbikqyrja e vazhdueshme periodike arkeologjike nga arkeologët e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik në bashkëpunim me arkeologët e DRKK Durrës, Korçë dhe Berat.

**IV.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**MINISTËR**

**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E KULTURËS TIRANË

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë
Tel: ++355 04 45 35 855
email: ***sekretaria.kka@asha.gov.al***
Website: www.asha.gov.al